



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 24.1.2025

Nr: 5

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 1, DATË 8.1.2025 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.1.2024, me pjesëmarrjen e:

Ledio	Braho	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ, referuar vendimit nr. 209, date 11.12.2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

BAZË LIGJORE: Nenet 19 pika 1 shkronja “c” dhe 21 pika 1 shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 22, pika 1 të Kodit Zgjedhor, ka kompetencën për të eksperimentuar dhe vendosur mbi përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve teknologjike në proceset zgjedhore. Kjo dispozitë, ndër të tjera, përcakton se përdorimi i teknologjisë duhet të realizohet përmes projekteve pilot, duke mbuluar të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit. Komisioni Rregullator, me vendim nr. 04, datë 13.11.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktoi karakteristikat dhe standardet teknike të pajisjeve të elektronike votimit dhe të numërimit (PEVN) që do të përdoren në proceset zgjedhore vijuese.
2. Me vendim nr. 16, datë 13.4.2023, “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionit Rregullator, u vendos që për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 14 maj 2023, PEVN të përdorej në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan. Këto tre bashki kanë gjithsej 401 qendra votimi (QV), me 347,561 votues të regjistruar.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim raportin mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në përfundim të procedurës administrative, Komisioneri nëpërmjet vendimit nr. 209, datë 11.12.2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, ka konstatuar shkelje në kundërshtim me Kodin Zgjedhor nga disa operatorë të PEVN.
4. Në vijim, KSHZ nëpërmjet kërkesës nr. 1, datë 8.1.2025, i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e masave administrative gjobë në masën 3,000 (tre mijë) lekë, referuar nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor.
5. Në përputhje me rregulloren “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, u hodh shorti për caktimin e relatorit dhe u caktua anëtari z. Ledio Braho si relator i shqyrtimit të kësaj çështjeje.
6. Në datën 24.1.2025 KAS-i me 4 (katër) anëtarë zhvilloi seancën e shqyrtimit të kërkesës së Komisionerit në prani të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së. Palët në proces, të cilët ishin njoftuar rregullisht për zhvillimin e seancës, nuk ishin prezent.
7. Përfaqësuesit e KQZ-së cituan se, KQZ në vlerësim të pretendimeve për veprimet e operatorëve të caktuar në ditën e votimit, bëri një shqyrtim të pamjeve filmike të përfituara nga kamerat e monitorimit në qendrat e votimit të të tre bashkive. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre

kamerave rezultoi se disa prej tyre nuk ofronin pamje të qartë për të nxjerrë konkluzione mbi mënyrën e përmbushjes së përgjegjësisve nga operatorët e PEVN. Gjithsesi, nga përmbajtja e atyre kamerave që kishin pamje filmike të qarta u evidentuan disa shkelje të procedurave nga ana e operatoreve si më poshtë:

Në Bashkinë Vorë u evidentuan 3 (tre) raste të dokumentuara:

- Operatori në QV nr. 1546/00 asiston/ndihmon votuesit, përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 1549/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 1563/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ.

Në Bashkinë Elbasan u evidentuan 12 (dymbëdhjetë) raste të dokumentuara:

- Operatori në QV nr. 2449/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2343/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2379/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2381/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2383/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2383/01 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2390/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2407/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2421/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2433/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2481/01 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 2432/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ.

Në Bashkinë Kamëz u evidentuan 2 (dy) raste të dokumentuara:

- Operatori në QV nr. 1589/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ;
- Operatori në QV nr. 1600/00 asiston/ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar dhe trajnuar nga KQZ

8. KAS-i mori në shqyrtim:

- Vendimin nr. 209, datë 11.12.2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”;
- Raportin mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023;
- Kërkesën nr. 1, datë 8.1.2025 të KSHZ drejtuar KAS për vendosje sanksioni administrativ.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi:

9. Votimi elektronik (përfshirë këtu edhe numërimi) është një proces që është pilotuar që nga zgjedhjet e vitit 2021 e në vijim në Shqipëri. Ky pilotim është organizuar në zona zgjedhore të ndryshme. Në vitin 2023, siç citohet edhe në hyrje të këtij vendimi, është zbatuar në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan.
10. Në lidhje me këtë proces, Komisioni Rregullator pranë KQZ-së, ka miratuar një sërë rregullash. Si fillim është miratuar vendimi nr. 14, datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjes elektronik të votimit dhe numërimit të zgjedhësve në qendrën e votimit, si dhe të procedurave të rekrutimit”, qëllimi i të cilit është “... përcaktimi i rregullave të pranimit dhe të trajnimit të personelit që do të caktohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) si operator teknik për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve në qendrat e votimit (QV) – neni 1 pika 1 e vendimit”. Po ashtu, në nenin 1 pika 2 shkronja “c” të këtij vendimi parashikohet se “Objekti i këtij vendimi është të përcaktojë: ... c) përgjegjësitë e operatorit teknik gjatë ofrimit të shërbimit”. Në vijim të këtij vendimi, në nenin 7 të tij, ndër të tjera parashikohet se:
- “1. Operatori teknik ushtron përgjegjësitë dhe përmbush detyrat e tij në mënyrë të paanshme dhe në përputhje të plotë me aktet e KQZ-së.*
- 2. Operatori teknik nuk ka rol vendimmarrës në lidhje me të drejtën e zgjedhësit për të votuar ose jo.*
- ...
- 6. Operatorët teknikë mbajnë përgjegjësi civile dhe/ose penale për veprimet/mosveprimet e tyre në kundërshtim me kontratën dhe/ose legjislacionin penal në fuqi”.*
11. Më tej, me vendimin nr. 16, datë 13.04.2023 të Komisionit Rregullator “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14

maj 2023” vendosi se “Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, procesi i votimit dhe numërimit elektronik të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë”.

12. Në përfundim, në lidhje me këtë procedurë votimi, Komisioni Rregullator ka miratuar edhe vendimin nr. 17, datë 13.04.2023 “Për miratimin e rregullave procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik me anë të pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Në pikën 9 të këtij vendimi është parashikuar se “Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit elektronik, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë”.

13. Me hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të sipërcituara, KShZ kreu edhe procedurën e rekrutimit për të gjithë operatorët teknikë që do të ushtronin detyrën në qendrat e votimit në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan. Secili nga operatorët teknikë të PEVN, ka lidhur një kontratë shërbimi me KQZ, ku kjo e fundit ka qenë në cilësinë e punëdhënësit. Në nenin 1 të kësaj kontrate është përcaktuar se:

“1. Objekt i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve juridike midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe personelit të kualifikuar (Operator) për përdorimin e pajisjes së votimit elektronik PEVN ditën e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore datë 14 Maj 2023.

2. Punëmarrësi emërohet si personel i kualifikuar i KQZ-së, këtu e më poshtë e njohur si “Operatori”.”

Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e operatorit, në nenin 5 të kësaj kontrate, ndër të tjera është parashikuar se:

“4. Operatori e përdor pajisjen PEVN në përputhje me manualin e përdorimit të saj, udhëzimeve të përshkruara në Aneksin nr.1 bashkëlidhur kontratës si dhe në aktet e tjera të KQZ.

...

6. Operatori gjatë përdorimit të pajisjes PEVN duhet të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

14. Ndodhur në këto kushte, në lidhje me udhëzimet konkrete për operatorin teknik të PEVN, do i referohemi Ankesit Nr. 1 të kësaj kontrate. Sa i përket detyrave të operatorit të PEVN gjatë ditës së dielë nga ora 06:00 deri në ora 19:00, në pikën 7 është parashikuar se “Operatori PEVN kryen ... 7. Monitorimi i procesit të votimit elektronik dhe ndihmesa e votuesit pa përmendur kandidat apo parti politike dhe pa kaluar asnjëherë pas pajisjes së votimit kur votuesi është duke votuar”.

15. Janë pikërisht të gjithë këto rregulla të miratuara dhe të dakordësuara më tej nëpërmjet kontratës së shërbimit nga vetë operatorët e PEVN, që duhet të zbatoheshin me rigorozitet ditën e zgjedhjeve për të garantuar të drejtën kushtetuese të votës vetjake, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë. Pavarësisht sa më sipër, nga këqyrja e filmimeve të qendrave të votimit (filmime këto të regjistruara gjatë gjithë ditës nëpërmjet kamerave të KQZ-së), ka rezultuar se në ditën e zgjedhjeve (14 maj 2023), operatorët e PEVN të cituar në hyrje të këtij vendimi kanë ndërmarrë rol aktiv, në tejkalim të asaj se çka parashikohet nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke orientuar një numër të konsiderueshëm zgjedhësish në kundërshtim me pikën 7 të Aneksit Nr. 1 të kontratës së lidhur me KQZ. Nga filmimet duke qartë që operatorët e PEVN i kanë ndihmuar zgjedhësit duke u pozicionuar në të njëjtin krah me ta dhe duke asistuar në proces paralel me ta, ndërkohë që duhet të pozicionoheshin në krah të kundërt me zgjedhësit. Veprime të tilla, përveçse bien ndesh me kontratën e sipërcituar, por bien ndesh edhe me vendimin nr. 17, datë 13.04.2023 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik me anë të pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, në pikën 9 të të cilit është parashikuar se *“Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit elektronik, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë”*.
16. Ndodhur në këto kushte, KAS vlerëson se duhet pranuar kërkesa e KShZ për vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në zbatim të nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor për operatorët teknikë të PEVN. Sipas kësaj dispozite *“Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë”*. Duke qenë se operatorët teknikë të PEVN janë persona të ngarkuar me detyra sipas K.Zgjedhor, shkelja e rregullave nga ana e tyre, klasifikohet si sanksion në bazë të kësaj dispozite. Megjithatë, në lidhje me masën e dënimit, KAS vlerëson se për shkak të frekuencës në shkelje dhe cënimit të një të drejte kushtetuese të zgjedhësve, masa e dënimit nuk duhet të jetë ajo minimale sipas propozimit të KShZ, por duhet përcaktuar në një vlerë tjetër, që korrespondon me 1/3 e pagës për shërbimin e kryer, për rrjedhojë masa e dënimit administrativ me gjobë do të jetë 5,000 (pesë mijë) lekë për secilin nga operatorët teknikë të PEVN.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të Kërkesës nr. 1, datë 08.01.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
2. Vendosjen e sanksioneve administrative gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, referuar nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor, ndaj Operatorëve të Pajisjeve Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN), sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative“, të ndryshuar” mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

U shpall sot më datë 24.01.2025

Ledio	Braho	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Operatorët me shkelje të PEVN

Bashkia Vorë

Nr	Emër	Atësi	Mbiemër	QV	ZAZ
1	Osman	Adem	Deda	1546/00	nr. 26
2	Arbër	Shkëlqim	Cenga	1549/00	nr. 26
3	Marko	Agron	Kalo	1563/00	nr. 26

Bashkia Elbasan

Nr	Emër	Atësi	Mbiemër	QV	ZAZ
1	Vilson	Vexhi	Fejza	2449/00	nr. 47
2	Marieta	Niko	Binjaku	2343/00	nr. 50
3	Ronaldo	Fatos	Zavalina	2379/00	nr. 47
4	Ledian	Arian	Kalashi	2381/00	nr. 47
5	Bleona	Hysen	Balla	2383/00	nr. 47
6	Fialdo	Fatmir	Mema	2383/01	nr. 47
7	Xhesika	Çlirim	Rira	2390/00	nr. 47
8	Elida	Saqi	Sina	2407/00	nr. 47
9	Juela	Arben	Stafa	2421/00	nr. 47
10	Valbona	Halil	Allustaj	2433/00	nr. 47
11	Bledi	Stavri	Panxhi	2481/01	nr. 47
12	Dritan	Xhaferr	Duraku	2432/00	nr. 47

Bashkia Kamëz

Nr	Emër	Atësi	Mbiemër	QV	ZAZ
1	Aldo	Nikë	Vukaj	1589/00	nr. 27
2	Ermira	Adem	Ademi	1600/00	nr. 27